



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR MAT

VENDIM

Nr. 1, datë 18/03/2026

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE DHE PROCES
TEKNOLOGJIKE, TË SUBJEKTIT “BERALB” SH.A.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për qëllime industriale dhe procese teknologjike, të subjektit “BERALB” sh.a, me vendndodhje: Fabrika e pasurimit të bakrit, Fushë-Arrës, Qarku Shkodër.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujqor: Lumi Fan i Madh

Koordinatat e vendndodhjes së burimit ujqor (KRGJSH):

X= 503228.72; Y= 4660130.21; Z= 543 m.m.n.d

Sasia e ujit që jepet për përdorim : $Q = 22$ l/sek

Prurja mesatare vjetore: $Q = 2.89$ m³/sek

Qëllimi i përdorimit : Për qëllime industriale në Fabrikën e pasurimit të bakrit.

Volumi që shkarkohet (m³/ditë): 1900.8 m³/ditë

Pika e shkarkimit në trupin uJOR pritës përfundimtar: lumi Fani i madh

X= 4659792.28; Y= 502929.18; Z= 520m m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL MAT

TAULANT MALSHI

